



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.268/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj, dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e Habib Leci, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Kamenicës, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë, e paraqitur kundër Komisionereve të Vendvotimit dhe QKN, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë **22.10.2025**, merr këtë:

V E N D I M

HEDHEN të palejuara (pasafatshme) ankesat ZL.Anr.268/2025, ZL.Anr.269/2025, ZL.Anr.270/2025, ZL.Anr.271/2025, dhe ZL.Anr.272/2025, të datës 19.10.2025, të parashtruara nga Habib Leci, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Kamenicës, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë, e paraqitur kundër Komisionereve të Vendvotimit dhe QKN, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 19.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesat ZL.Anr.268/2025, ZL.Anr.269/2025, ZL.Anr.270/2025, ZL.Anr.271/2025, dhe ZL.Anr.272/2025, të parashtruara nga Habib Leci, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Kamenicës, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë, ku në ankesën ZL.Anr.268/2025, thekson se në vendvotimet 1026/01 dhe 1026/02 në Muqiverc, i kam të garantuara dhe të vertetuara se familjarët e mi kanë votuar në këto vendvotime mirepo të gjitha votat mungojnë, për këtë arsye dyshimet janë të theksuara se ka pas manipulime në këto qendra votimi, theksohet në ankesë.

Në ankesën ZL.Anr.269/2025, theksohet se në vendvotimin 1011/01, 1011/02, 1011/03 në Roganë dyshon se ka keqpërdorime dhe mungese të votave si dhe kërkon rinumërim në këto vendvotime pasi që njerëzit të cilët kane votuar thekson se janë të gatshëm të dëshmojnë se kanë votuar.

Në ankesën ZL.Anr.270/2025, thekson se në vendvotimet 1004/01, 1004/02 dhe 1004/03 në Topanicë dyshon se ka pasur shkelje dhe i mungojnë votat, dhe se këto dyshime lindin pasi që persona familjar sipas parashtruesit të ankesës janë të gatshëm të dëshmojnë mirëpo votat nuk janë, dhe në veçanti thekson se edhe motra kishte qene komisionere në njërin prej klasave të vendvotimit në Topanicë.

Në ankesën ZL.Anr.271/2025, theksohet se në vendvotimin 1022/01 dhe 1022/02 në Hodonoc dyshon se është bërë keqpërdorim i votës, sepse jam i informuar dhe garantuar nga vajzat e agjes me familjet e tyre se me kanë votuar mirëpo pas numërimit në QKN, nuk janë votat për mua theksohet në ankesë.

Në ankesën ZL.Anr.272/2025, theksohet se në vendvotimin 1020/01, 1020/02, 1020/03 dhe 1020/04 në Koretin votuesit familjarë me kanë garantuar dhe konfirmuar se me kanë votuar, mirëpo votat nuk janë të numëruara, dhe se dyshon se votat i janë në humbur nga komisioneret e QKN-së.

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja thekson se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/1.228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024,

Qendrat Komunale të Numërimit QKN, Procedurat e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN.

Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). KQZ, ju njofton se, rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre.

Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese që mbështeten në deklaratimet e familjarëve dhe miqve, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të

Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit. Gjithashtu konsiderojmë se ankesa është e pasafatshme, sepse pas konfirmimit të KKZ, në komunën e Kamenicës, aktiviteti i QKN-së është përmbyllur me datën 16.10.2025, ndërsa pala ankesën e ka parashtruar me datën 19.10.2025. Pra nuk është brenda afatit ashtu siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, sipas të cilit "105.1. Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar. KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë,

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZL.Anr.268/2025, ZL.Anr.269/2025, ZL.Anr.270/2025, ZL.Anr.271/2025, dhe ZL.Anr.272/2025, të datës 19.10.2025 të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët ZL.A.nr.268/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesave dhe shkresave të lëndës konstaton se:

- *Ankesat janë të palejuara (pasafatshme).*

Paneli, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka gjetur se ankesat e parashtruara nga Habib Leci, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Kamenicës, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), të paraqitura kundër Komisionerëve të Vendvotimit dhe QKN, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), janë të parashtruara pas afatit të përcaktuar ligjor.

Me dispozitën e nenit 105 paragrafi 1, në mënyrë decitive parashihet se "Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar," të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Me dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, parashihet që " *Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara*", ndërsa nën paragrafi 5.16. parashihet që " *Për shkeljet e pretenduara gjatë procesit të administrimit dhe numërimit në QKN dhe QNR*".

Në rastin konkret Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesat në PZAP me datë 19.10.2025, ku ka pretenduar se disa familjarë të tij i kanë garantuar se kanë votuar në vendvotimet: 1004/01, 1004/02, 1004/03 në Topanicë, vendvotimin 1022/01, 1022/02 në Hodonovcë, vendvotimin 1020/01, 1020/02, 1020/03 në Koretin, në vendvotimet 1026/01, 1026/02 në Muqivërc, dhe në Roganë në vendvotimet 1011/01 dhe 1011/02, ndërsa nga të dhënat zyrtare, e po ashtu edhe nga përgjigja e KQZ është vërtetuar se aktiviteti i QKN-së në Komunën e Kamenicës, *është përmbyllur me datën 16.10.2025*, me çka vërtetohet se ankesat e ankuesit nuk janë paraqitur brenda afatit ligjor siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, andaj dhe të njëjtat u deshtë që të hedhen si të palejuara (pasafatshme).

Andaj, nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 115 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.16, neni 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL.Anr.268/2025 më datën 22.10.2025

Kryesues i Panelit

Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.